

REPUBLIKA E KOSOVËS

Regj.Nr.12162/12

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI KUNDËRVAJTJES,sipas Gjykatësit Ramush Ademi, si dhe procesmbajtësit sek.jur. Nuhi Ismaili, kundër të pandehurit Nikolla Dimitrijeviq nga F.sh. Pasjan, për kundërvajtjen nga neni 17 paragrafi 1.3 të ligjit nr. 04/L-050 të ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjith Personat Zyrtar. E në bazë të nenit 73, 74, 195 dhe 199 dhe 9 të ligjit mbi kundërvajtjet me dt. 12.02.2013 muar këtë:

AKTVENDIM

I pandehuri Nikolla Dimitrijeviq nga babai Zhivko, i lindur me 16.12.1964 në Gjilan me vendbanim në F.sh. Pasjan, Serb, shtetas i Republikës Kosovës, me profesion Ing. I Bujqësisë i martuar baba i 3 fëmijëve i gjendjes së mesme ekonomike, kinse nuk është i denuar e as nën hetime, madhor.

ËSHTË PËRGJEGJËS

Sepse me dt: 04.04.2012 ka dërguar formularin për deklarimin e pasurisë zyrtari i lartë këshilltar komunal pran KK- së Partesh, pas afatit të parapar ligjor që ditë e fundit ka qenë 31.03.2012.

-Me këtë veprim ka bërë veprën kundërvajtëse nga neni 17 parag.1.3.nr. 04/L-050 Për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Zyrtarëve të lartë Publik dhe deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjith Personat Zyrtar, e për ate shpallet përgjegjës dhe

DËNOHET

Me dënim gjobe në shumë prej 300(treqind)Euro.

Obligohet i pandehuri që dënimin e shqiptuar ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmëris së këtij Aktvendimi në të kundërtën, do ti zëvendësohet në dënim burgu në kohëzgjatje prej 15 ditësh, duke llogaritur 20 (Njëzet) Euro për një ditë burgu të filluar.

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjygjësor ti paguaj kësaj gjykate shumën prej 10 (Dhjet) Euro, në afatin e njejtë si dënimin me gjobë.

Me nga një kopje të Aktvendimit të njoftohen palët në procedur.

Arsyetim

Agjacioni Anti Korruption nga Prishtina me kërkesën e vet nr.01-2517/12 të dt: 24.07.2012, ka kërkuar që kundër të pandehurit të shpallet përgjegjës, të ndëshkohet sipas ligjit.

Gjykata shqyrtoi kërkesën dhe konstatoi se e njejta është e bazuar në ligj.

Gjykatesi për Kundërvajtje ndërmur procedurën duke dëgjuar të pandehurin i cili ka deklaru se vërtet formularin e plotësuar, për lajmrimin e pasurisë ka qen i obliguar, sipas ligjit ta plotësoj dhe ta dërgoj pran agjacioni të lartpërmendor gjer më dt.31.03.2012 si ditë e fundit. Më tutje ka cekur se formulari i plotësuar është dërguar pas këti afati ligjor gjegjësisht me dt.04.04.2012.

DPK/DMP
02
03-553/2013
21.02.2013

03-553/2013/02
feng

Në mbrojtjen e vet është përpjekur, të arsyetoj se formularin e plotësuar e ka dorëzuar tek zyrtari i Komunës së Parteshit me dt.30.03.2012, por zyrtati në fjal me qëllim të keq- nga inati ndaj këshilltarëve të opozitës nuk i ka dërguar formularët gjer me dt.31.03.2012 por pas këtij afati.

I pandehuri e pohoi kundërvajtjen por lut gjykatën që ta ket parasysh ate që u tha në mbrojtjen e tij duke kërkuar që ti shqiptohet një dënim sa më i but dhe ate nën minimumn e parapar ligjor.

Gjyqtari pasi shtjelloi provat dëgjimin e të pandehurit, pohimin e kundërvajtjes nga ana e tij, nuk pati nevoj të shtjelloj prova tjera andaj e shpalli përgjegjës dhe e ndëshkoi me dënim gjobe njejt si në dipozitiv të këtij Aktvendimi, në bazë të nenit 17 parag.1.3 të ligj. Nr. 04/L-050.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënit me gjobë me kujdesë vlerësoi mbrojtjen e të pandehurit, kërkesën për iniciimin e procedurës kundërvajtëse dhe shkresat e tjera të lëndës, e ndëshkoi me dënim gjobe, duke patur parasysh rrethanat lehtësuese si dhe ato rënduese për veprën kundërvajtëse në fjalë. Gjykatësi të pandehurit i zbuti dënimin nën minimumn e paraparë sipas ligjit të lartpërmendur, duke u bazuar në nenin 9 të LMK. Posaqërisht si rrethan lehtësuese i mori se i pandehuri formularin e plotësuar tek zyrtari kompetent pran KK-së Partesh e ka dorëzuar m kohë me dt.30.03.2012, se kjo është kundërvajtja e par, se është zotuar se në të ardhmen nuk ka për ta përsëritur kundërvajtjen. Gjersa si rrethana rënduese i mori peshën e kundërvajtjes së kryer, dhe i shqiptoi këtë dënim, i bindur se edhe me këtë dënim ka për tu arrit qëllimi i dënit tek i pandehuri. Vendimi mbi paushallin gjygjësor është marr, në bazë të nenit 109 parag.1 pikë 6 të LMK.

Me sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN DEP. PËRGJITHSHËM – DIVIZ. KUNDËRVAJTJES

Me dt. 12.02.2013

Sek.Juridik:

Nuhësmafi



Gjyqtari
Ramushe Ademi

UDHËZIMI MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij Aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së këtij Aktvendimi Gjykatës së Apelit në Prishtinë – Divizionit Kundërvajtjes, ankesa dorëzohet përmes këtij Divizioni Kundërvajtjes.